



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Bilisht, më _____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“Furnizim –vendosje Goma”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Goma per Automjete te renda/ te lehta 34350000-5**

VLERA E FONDIT LIMIT: **2,250,000 (dy milion e dyqind e pesdhjete mije) leke pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar , nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Devoll** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit e shtojces (Shtojca 9).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023,2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 55, pika 4, “Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM “Për rregullat e prokurimit publik”, e cila parashikon se Autoriteti kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për pervojën e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të kontratës.

Për të vërtetuar pervojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.i ndryshuar Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 55, pika 4, germa b) në vlerën 20% të fondit limit.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të shërbimit të kërkuar objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal të lejuar dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi një ambient pune (gomisteri) të përshtatshme brenda territorit të Bashkisë Devoll. Për këtë, operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton pronësinë/ huapërdorjen/ qiramarrjen si më poshtë:

a. Dokumentacion që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

b. Dokumentacion që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huapërdorje (e vlefshme).

c. Dokumentacion që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje (e vlefshme).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në bazë të nenit 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pikës 5 e nenit 40, Kreu V të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). AK kërkon nga OE që të kenë një ambient në pronësi/qira/ huapërdorje të nevojshëm për Cmontimin-montimin dhe balancimin e gomave.

Ky ambient kërkohet të jetë në territorin e Bashkisë Devoll për shkak të numrit të lartë të mjeteve dhe mjetet e rënda të cilat Bashkia Devoll disponon. Nderimi dhe balancimi i gomave në një gomisetri larg territorit të Bashkisë Devoll do të sillte kosto dhe efekte negative për Bashkinë. Në mënyrë që të vërtetohet që operatorët ekonomikë disponojnë hapësirën e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së tyre gjykojmë se është e nevojshme demonstrimi i këtij fakti përmes paraqitjes së një dokumenti i cili vërteton pronësinë, huapërdorjen, qiramarrjen referuar dispozitave përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **deklaratë mbi garancinë e gomave**, garancia e kilometrazhit të përshkruar në shfrytëzim normal sipas kushteve teknike të shfrytëzimit do të jetë jo më pak se 40,000 (dyzet mijë) km. Operatori ekonomik i shpallur fitues gjatë periudhës së garancisë është i detyruar të kryejë zëvendësimin e gomave me difekt për shkak të prodhimit ose cilësisë së dobët, pas marrjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë për garancinë e gomave dhe se marrin përsipër të kryejnë zëvendësimin e tyre në rast se demtimi i tyre vjen si pasojë e difekteve për shkak të rëndësimit apo difekteve për shkak të ruajtjes në ambiente të papapershtatshme nga OE. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të se ciles mer përsipër cmontimin-montimin dhe balancimin e gomave në gomisterinë e tij me pajisje bashkekohore.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër të kryejnë shërbimin e cmontimit, montimit dhe balancimin e gomave në ambientin e tij të gomisterisë me mjetet dhe pajisje bashkekohore. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike për gomat janë vendosur në përputhje me LPP-së dhe në to përcaktohen qartë karakteristika e mallit objekt prokurimi duke mos përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Specifikimet teknike në rastin konkret janë vendosur për të përshkruar teresine e elementeve me të rendesishme të gomave të cilat garantojnë AK për cilësinë e tyre. Specifikimet teknike janë vendosur duke pasur parasysh edhe rruget dhe kushtet atmosferike të Bashkisë Devoll me qëllim marrjen e mallrave me cilësi dhe jetëgjatësi. Këto specifikime nuk përbëjnë pengesë për konkurrencën e hapur dhe pjesënarrjen e OE të cilët operojnë në fushën e tregëtimit të gomave, gomistrive etj.

^SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Gomat të jenë të prodhuara për në BE
2. Gomat nuk duhet të jenë të riveshura
3. Përmasat e gomave duhet të jenë sipas preventivit me poshte:
4. Gomat duhet të jenë prodhim i gjashtëmuajorit të parë të vitit 2026
5. Garancia e gomave të automjeteve jo më pak se 40.000 (dyzetëmijë) Km ose 2 vjet.
6. Në çmim përfshihet: montimi dhe balancimi i gomave.
7. Operatori ekonomik të ketë ambjent që respekton kushtet teknike të ruajtjes së gomave dhe ambjent me paisjet e nevojshme për cmontim- montim dhe balancim të gomave;
8. Për gomat e automjeteve sipas certifikimeve europiane duhet të jenë të stines verore, kursimi I karburantit të jetë minimumi klasa B.
9. Frenimi në lageshtirë të jetë minimumi klasa B.
10. Zhurma të jetë nga 68-70 dB.

Njesia e Prokurimit: